



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2021:068503  
Datë: 29.03.2024  
Numri i dokumentit: 05523411

C.nr.457/2021

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtarja Florije Qerimi, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditëses K. G. M. A. M. F., me adresë në P., e përfaqësuar nga Debt Loan Recovery L.L.C. Rruga “Enver Maloku: nr.108 Prishtinë, kundër të paditurve Sh. B. dhe E. B., që të dy nga fshati P., komuna e Gj., me objekt kontesti realizimin e borxhit, me vlerë të kontestit 1,791.58 euro, pas mbajtjes së seancës për shqyrtim përgatitor më datë 19.03.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

I. KONSIDEROHET SE ËSHTË TËRHEQUR padia e paditësit K. G. ., me adresë në P., e ushtruar kundër të paditurve Sh. B. dhe E. B., që të dy nga fshati P., komuna e Gj., me objekt kontesti realizimin e borxhit, me vlerë të kontestit 1,791.58 euro.

A r s y e t i m

Paditësja, përmes të autorizuarës së tij, më datë 13.04.2021, ka paraqitur padi në këtë gjykatë kundër të paditurve Sh. B. dhe E. B., që të dy nga fshati P., komuna e Gj., me objekt kontesti realizimin e borxhit.

Gjykata në lidhje me këtë çështje kontestimore ka caktuar seancën përgatitore për të cilën seancë, palët ndërgjyqëse kanë qenë të ftuara në mënyrë të rregullt. Pavarësisht se paditësi, sipas fletëkthesës që gjendet në shkresat e lëndës, ku shihet se më datë 17.01.2024 ka pranuar thirrjen e rregullt për këtë seancë, nuk ka prezantuar në seancë dhe mungesën nuk e ka arsyetuar, poashtu në seancë kanë munguar edhe të paditurit.

Gjykata, duke marrë parasysh se paditësi ka munguar në shqyrtim gjyqësor, në rastin konkret ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenin 409 parag.1 të LPK-së “Në qoftë se në seancën përgatitore nuk vjen pala paditëse, edhe pse është thirrur rregullisht, padia konsiderohet e tërhequr, përveç kur i padituri kërkon që seanca të mbahet”.

Nga të cekurat më lartë dhe në bazë të nenit 409 parag.1 të LPK-së, gjykata vendosi si në pikën I të dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

C.nr.457/2021, datë 19.03.2024

Gjyqtarja,  
Florije Qerimi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditë, pas pranimit të të njëjtit, nëpërmjet kësaj gjykate.